



**PASQYRAT FINANCIARE DHE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR
PËR PERIUDHËN 01.01.2025-31.12.2025**

SC "GJILANI" Sh.p.k.

Përmbajtja:

Informata të përgjithshme mbi entitetin.....	4
Raporti i auditorit të pamvarur.....	5
Pasqyrat financiare.....	8
Pasqyra e politikave të rëndësishme të kontabilitetit.....	14-15

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

1. Informta të përgjithshme

SC "GJILANI" Sh.p.k. është regjistruar ("Kompania") është themeluar si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Kompania është themeluar më 05.04.2017 dhe vepron në përputhje me dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare" nr. 02 / L-123, Ligji "Për Regjistrin Tregtar" nr. 02 / L-54, me numër regjistrimi të biznesit 810015835. Adresa e operimit të kompanisë është në rruga Zija Shemsiu p.n. Gjila, , Republika e Kosovës.

Pronarët:

Fatlum Pireva me 60% akcione

Valmir Emini me40 % akcione

Aktiviteti kryesor është:

9319-----Aktivitetet e tjera sportive

9311-----Funksionimi i objekteve sportive

9329-----Aktivitetet e tjera të argetimit dhe rekreacionit

9312-----Aktivitetet e klubeve sportive

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e SC "GJILANI" Sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të SC "GJILANI" Sh.p.k., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31.12.2025, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe shënimet në pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë) pozicionin financiar të Kompanisë 31 dhjetor 2025, dhe rezultatin e saj financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për NVM (SNRF për NVM).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për NVM (SNRF për NVM), dhe për kontrollet e brendshme, në masën që përcaktohet nga menaxhmenti, është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare të SC GJILANI SH.P.K. më dhe për vitin e mbyllur më për me 31 Dhjetor 2025 në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ato ekzistojnë.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritët që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontroleve të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Kompanisë. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Kompania të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Kompanisë përveç të tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme të kontrollit të brendshëm që ne kemi identifikuar gjatë auditimit.

Besa Sahitaj Berisha-Partnere

ECOVIS UA KOSOVA SH.p.k.
Q.T.Bregu i Diellit lok.26
Prishtinë Tel.+38344124898



Prishtinë, 26.02.2026

SC GJILANI - sh.p.k.

Gjilan

NRB/NF: 810015835

**Pasqyra e Pozitës Financiare
më 31 Dhjetor 2025**

Shënimi	Me 31.12.2025 €	Me 31.12.2024 €
PASURITË		
Pasuritë afatshkurtra		
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	314,555	432,466
Llogarite e arketueshme nga transferimi i lojtareve		
Pasuritë e tjera afatshkurtra		
Gjithsej pasuritë afatshkurtra	314,555	432,466
Pasuritë afatgjata		
Pasurite e paprekshme - lojtarët		
Llogarite e arketueshme nga transferimi i lojtareve		
Gjithsej pasuritë afatgjata		0
Gjithsej pasuritë	314,555	432,466
DETYRIMET DHE EKUITETI		
DETYRIMET		
Detyrimet afatshkurtra		
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër	81,000	246,500
Llogarite e pagueshme në lidhje me transferimin e lojtareve		
Llogaritë e pagueshme në lidhje me obligimet sociale/organet tatimore	8,290	6,432
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	900	8,148
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër		
Gjithsej detyrimet afatshkurtra	90,190	261,080
Detyrimet afatgjata		
Kreditë bankare dhe të tjera		-
Detyrimet e tjera afatgjata		-
Gjithsej detyrimet afatgjata		0
Gjithsej detyrimet	90,290	261,080
EKUITETI		
Kapitali i pronarit		
Kapitali aksionar	53,000	53,000
Fitimet e mbajtura	171,365	118,386
Rezervat e tjera		
Gjithsej ekuiteti	224,365	171,386
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet	314,555	432,466

Drejtori Ekzekutiv

Fatlum Pireva



(emri, mbiemri, nënshkrimi)



Drejtori Financiar

Syart Rrahmani

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse
për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

Shënimi	Për vitin që përfundon me 31.12.2025 €	Për vitin që përfundon me 31.12.2024 €
Të hyrat		
Te hyrat nga shitja e biletave	760	1,878
Sponsorizimi dhe reklamat	525,100	485,999
Të hyrat tjera komerciale	20,162	10,970
Solidariteti i UEFA dhe çmimi i parave	374,700	147,177
Të hyrat tjera operative		-
Fitimi / (humbja) bruto	920,722	646,024
Shpenzimet		
Kostoja e shitjes / materialeve		-
Shpenzimet e perfitimit te punonjesve (lojetareve)	114,869	124,954
Shpenzimet e perfitimit te punonjesve (punonjes tjere)	93,296	51,051
Amortizimi/zhvlersimi i aseteve themelore fikse (regjistrimi i lojtarve)	-	-
Zhvlerësimi i aseteve te prekshme dhe / ose aktiveve jo-materiale fikse (duke përjashtuar regjistrimet e lojtarve)	-	-
Tregtimi(shitja) i lojtarve	-	-
Amortizimi i aktiveve jo-Materiale Fikse (regjistrimet e lojtarve)	-	-
Zhvlerësimi i aktiveve jo-Materiale (regjistrimet e lojtarve)	-	-
Kostoja e regjistrimit te lojtarve (dukë përfshirë edhe agjentet e pakapitalizuar/tarifat e ndërmjetme dhe kredite)	-	-
Shpenzimet tjera	653,691	426,304
Fitimi / (humbja) operativ	58,866	43,715
Shpenzimet financiare		
Të ardhurat financiare		
Fitimi / (humbja) para tatimit	58,866	43,715
Shpenzimet e tatimit në fitim	5,887	- 4,372
Fitimi / (humbja) i/e vitit	52,979	39,343
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:		
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave të operacioneve të huaja, neto nga tatimi		
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit:		
Gjithsej të ardhurat/(humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit	52,979	39,343

SC GJILANI SHPK

NUI: 810015835

**Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet
për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

	Kapitali i pronarit €	Fitimet e mbajtura €	Rezervat e tjera €	Gjithsej €
Gjendja më 1 janar 2024	53,000	79,043	-	132,043
Fitimi / (humbja) i/e vitit		39,343	-	39,343
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividentët / Tërheqjet				
Deponimet e kapitalit shtesë				
Ndarja e rezervave				
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	53,000	118,386	-	171,386
Fitimi / (humbja) i/e vitit		52,979	-	52,979
Diferencat nga përkthimet valutore				-
Dividentët / Tërheqjet	-		-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-		-	-
Ndarja e rezervave		-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2025	53,000	171,365	-	224,365

Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë
për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

Shënimi	2025	2024
	€	€
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	52,979	39,343
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave		
Të ardhurat financiare		
Shpenzimet financiare		
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve		
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe		
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	-	71,884
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	-7,248	4,201
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	-163,642	63,457
Tatimi në fitim i paguar		
Interesi i paguar		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	-117,911	178,885
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme		
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme		
Interesi i arkëtuar		
Dividendat e arkëtuara		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	-	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Deponimet e kapitalit shtesë		
Tërheqjet		
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë		
Ripagimi i kredive dhe huave (pagesë e detyrimeve afatgjata)		
Pagesat e lizingut financiar		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	-	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	-117,911	178,885
Rikonsulimi		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	432,466	253,581
Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në bilancin e parave të gatshme dhe parave të huaja të mbajtura		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	314,555	432,466

1. DEKLARATA E PËRPUETHSHMËRISË

Pasqyrat financiare të SC "GjILANI" Sh.p.k. janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për NVM (SNR për NVM).

2. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1 Baza e matjes

Pasqyrat financiare për SC "GjILANI" Sh.p.k. janë përgatitur në bazë të matjeve të përcaktuara me SNRF për secilin lloj të pasurisë, të përgjegjësisë, të ardhurave e shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë.

2.2 Valuta e përdorur

Valuta funksionale SC "GjILANI" Sh.p.k. është valuta e Bashkimit Evropian Euro ("EUR"). Pasqyrat financiare janë prezantuar në euro.

2.3 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë janë konsideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse. SC "GjILANI" Sh.p.k. operon me llogaritë bankare të hapura në Banka Ekonomike.

2.4 Të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet tregatre fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas mbarten me kosto minus provizionet, nëse ka. Një provizion njihet kur ka dëshmi objektive që Organizata nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve. Shembuj të dëshmive objektive mund të jenë vështirësitë e mëdha financiare të klientit, probabiliteti i madh që klienti të falimentojë si dhe vonesat e vazhdueshme në pagesa

2.5 Prona, impiantet dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Prona, toka dhe pajisjet e biznesit janë deklaruar në pasqyrën e pozicionit financiar me koston historike minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e dëmtimit në vlerë.

Paisjet paraqiten me koston e tyre minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia e vlerës së tyre. Zhvlerësimi njihet në mënyrë që të anulojë koston apo vlerësimin e mjeteve minus vlerat e mbetura mbi dobishmërinë e tyre, duke përdorur metodën lineare. Jetëgjatësia, vlera e mbetur dhe metoda e amortizimit rishikohen në çdo datë raportimi, me efektin e ndonjë ndryshimi në vlerësim, atëherë ndryshimet llogariten në periudhën e ardhshme.

Fitimi ose humbja që paraqitet me rastin e shitjes ose nxjerrjes nga përdorimi i një pasurie përcaktohet si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të një pasurie dhe si rrjedhojë njihet si fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) *Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi i pronës dhe paisjeve është llogaritur duke përdorur metodën drejtvizore për shpërndarjen e kostos ose koston e konsideruar tek vlera e mbetur e tyre përgjatë jetëgjatësisë së tyre të përdorimit si në vijim:

Ndërtesat 20 vite

Pasuritë tjera jo qarkulluese 5 vite

2.6 Asetet Jo-materiale fikse – lojtarët

Transferimi dhe shpenzimet e rastit që lidhen me blerjen e lojtarëve të regjistruar kapitalizohen si aktive fikse të patrupëzuara.

Këto kosto janë amortizuar plotësisht, në këste të barabarta vjetore, gjatë periudhës së kontratave të lojtarëve respektiv.

Nuk përfshihen shumat e lojtarëve brenda klubit. Kur rinegociohet një kontratë, së bashku me shpenzimet e reja që lidhen me zgjerimin e kësaj kontrate, duhet të amortizohen gjatë afatit të kontratës së re.

Çdo tarifë transferimi e pagueshme si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve në të ardhmen duhet të kapitalizohet, kur është e mundur që një ngjarje e tillë do të ndodhë.

Regjistrimet e lojtarëve duhet të zhvlerësohen, kur vlera kontabël neto tejkalon shumën e rikuperueshme përmes përdorimit ose shitjes.

2.7. Përfitimet e punëtorëve

SC GJILANI SH.P.K. në rrjedhat normale të biznesit, bënë pagesat në emër të punëtorëve të vetë për kontributet pensionale dhe tatimet në të ardhurat personale të cilat janë të kalkuluara në bazë të pagave bruto sipas legjislacionit në fuqi. Këto shpenzime i ngarkohen pasqyrave të ardhurave për periudhën e caktuar kohore.

Në rrjedhat normale kompania në fjalë bënë përlllogaritjen dhe pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në burim, konform rregulloreve dhe ligjeve aktuale në Republikën e Kosovës.

2.8 Të hyrat

Të hyrat përfaqësojnë të ardhurat e arkëtueshme nga aktivitetet kryesore të njësisë ekonomike duke përjashtuar tarifat e transferimit për shitjen lojtar të regjistruar dhe tatimin mbi shitjen.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshmeve dhe përfaqësojnë shumat e arkëtueshme për mallrat dhe shërbimet e ofruara në rrjedhën normale të biznesit.

2.8.1 Faturat e hyrjes në stadion / të ardhurat e ndeshjes së ditës

Të ardhurat e lojës të ditës njihen me ndeshjet e luajtura gjatë gjithë vitit dhe pranohen vetëm atëherë kur ka përfunduar ndeshja.

Të ardhurat e ndeshjes të ditës që janë marrë paraprakisht fund të vitit, por kanë të bëjnë me vitin e ardhshëm (p.sh. Shitjet e biletave sezonale) duhet trajtuar si të ardhura të shtyra dhe regjistrohen si të ardhura për ndeshje që kanë përfunduar.

2.8.2.Sponzorizimi dhe reklamimi

Sponzorizimi dhe reklamati përfshijnë sponzorët kryesore, sponzorë të tjerë, perimetritin e ndeshjeve dhe reklamati e bordit, si dhe sponzorizimin dhe reklamati e tjera.

2.8.3 Të drejtat e transmetimit

Të ardhurat nga të drejtat e transmetimit përfaqësojnë të ardhurat e arkëtueshme nga kontratat e mediave vendase. Shpërndarjet në lidhje me performancën e ekipit njihen kur ato bëhen të sigurta.

2.8.4 Të hyrat komerciale

Të ardhurat komerciale përfshijnë të hyrat nga tregtimi, shitja e ushqimit dhe pijes, konferencat, llotaria dhe të ardhurat e tjera komerciale vetëm nëse nuk kategorizohen ndryshe.

2.6.7 Të hyrat tjera

Të ardhurat tjera përfshijnë donacione, grante mirpo asnjë të ardhur të jashtëzakonshme operative dhe të hyra të tjera jo të ndara për pesë kategoritë e tjera.

3.MENAXHIMI I RISKUT

3.11 Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Kompania menaxhon kapitalin e saj për të siguruar që do të jetë në gjendje për të vazhduar në vijimësi duke maksimizuar kthimin përmes optimizimit të detyrimeve dhe të bilancit të kapitalit të vet.

Struktura e kapitalit të SC GJILANI Sh.p.k. përbëhet nga kapitali i depozituar dhe fitimet e mbajtura.

a) Instrumentet financiare

Vlera e drejtë e parasë dhe ekuivalentëve të saj, llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme shtë për afërsisht e barabartë me vlerën kontabël për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër. Vlera e rejtë e huave dhe kredive është për afërsisht e barabartë me vlerën e mbartur për shkak se kreditë mbajnë norma të ndryshueshme interesi që reflektojnë ndryshimet në kushtet e tregut.

b) Administrimi i rrezikut financiar

Kompania është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku i kredisë
- Rreziku i likuiditetit

3.1 Ndikimi mbi konsumatorët / huamarrësit

3.2 Rreziku i kredisë

Rreziku i mos - pagesës ekziston kur pala tjetër nuk mund të përmbushë detyrimet e tij për të paguar llogaritë e arkëtueshme. Rreziku maksimal i kredisë për instrumentet financiare jo-derivative është përafërsisht e barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arkëtueshme detyrimeve minus ndaj ebitorit të njëjtë kur kompensimi është i lejuar.

3.3 Rreziku i likuiditetit

Kompania duhet të plotësojnë nevojat për mjete financiare , kryesisht për shpenzimet operative që rrjedhin nga veprimtaria e tij. Ekziston rreziku që të mjetet financiare të mos jetë në dispozicion për të paguar detyrimet në kohën e duhur me një kosto të arsyeshme të rrezikut të normës së interesit

Kompania përballet me rrezikun e normës së interesit të lidhur me kredi nga disa banka , e cila është një normë e ndryshueshme. Menaxhmenti nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative të mbrojnë këtë rrezik.

3.4 Rreziku i normës së këmbimit

Kompania ndërmerr transaksione në Euro dhe valuta tjera. Kompania nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për kontratat e të ardhmes të këmbimit më 31 dhjetor, 2025 .

4. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	Me 31.12.2025	Me 31.12.2024
	€	€
Paraja në arkë	49,191	82,373
Paraja në bankë	265,364	350,093
	314,555	432,466
Për qëllime të pasqyrës së rrjedhjes së parasë së gatshme, paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshinë:		
	Me 31.12.2025	Me 31.12.2024
	€	€
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	314,555	432,466
Total paraja dhe ekuivalentët e parasë	314,555	432,466

5. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

	Me 31.12.2025	Me 31.12.2024
	€	€
Të pagueshmet ndaj furnitorëve	900	8,148
Total llogaritë e pagueshme	900	8,148

6. Detyrimet e tjera afatshkurta

	Me 31.12.2025	Me 31.12.2024
	€	€
Detyrimet ndaj kontributeve pensionale	1,442	1,276
Detyrimet ndaj tatimit ne paga	954	784
Detyrimet ndaj tatimit	5,894	4,372
Total detyrimet tjera afatshkurtëra	8,290	6,432

7. Kreditë dhe huatë

	Me 31.12.2025	Me 31.12.2024
	€	€
Afatshkurtra		
Huazimet	81,000	246,500
Total kreditë dhe huatë	81,000	246,500

8. Të hyrat

	Për vitin që përfundon me 31.12.2025	Për vitin që përfundon me 31.12.2024
	€	€
Te hyrat nga shitja e biletave	760	1,878
Sponsorizimi dhe reklamat	525,100	485,999
Të hyrat tjera komerciale	20,162	10,970
Solidariteti i UEFA dhe çmimi I parave	374,700	147,177
Total të hyrat	920,722	646,024

9. Shpenzimet e shperndarjes

	Për vitin që përfundon me 31.12.2025	Për vitin që përfundon me 31.12.2024
	€	€
Shpenzimet e perfitimit te punonjesve (lojetareve)	114,869	124,954
Shpenzimet e perfitimit te punonjesve tjere	93,296	51,051
Total shpenzimet e shpërndarjes	208,165	176,005

10. Shpenzimet administrative

	Për vitin që përfundon me 31.12.2025	Për vitin që përfundon me 31.12.2024
	€	€
Shpenzimet ne FFK	7,750	8,710
Shpenzimet bankare	989	1,170
Shpenzimet e fazes Pergaditore	41,719	63,247
Shpenzimet e transportit	12,630	8,250
Shpenzimet e sigurimit (Policia e Kosoves)	3,690	3,625
Shpenzimet e Auditimit	800	800
Shpenzimet e produkteve medicinale	3,878	2,101
Shpenzimet per karantina	16,941	10,732
Shpenzimet e veshmbathjeve	14,911	23,318
Shpenzimet e rigjenerimit	78	336

Shpenzimet e biletave te aeroplanit	13,510	8,478
Shpenzimet e Ushqimit	12,918	16,058
Shpenzimet e pajsjeve sportive	5,141	4,203
Shpenzimet e marketingut	4,620	
Shpenzimet e tjera	506,686	269,138
Shpenzimet e kontributit pensional punedhenesi	7,430	6,138
Total shpenzimet administrative	653,691	426,304

13. Detyrimet kontigjente

(Nëse është e aplikueshme, ekzistenca e detyrimeve kontigjente)

Sipas kushteve të kontratave të caktuara për blerjen e lojtarëve të regjistruar, pagesat e ardhshme mund të jenë shkak, ose të varura në suksesin e ardhshëm të ekipit dhe/ose zgjidhjen e individuale të ekipit për lojtarë të rinjë

Deri në fund të periudhës nuk ka pasur detyrime kontigjente që është dashur të shpalosen.

14. Ngjarjet pas mbylljes së librave

(Nëse aplikohen, ngjarjet pas datës së bilancit):

Që nga data e bilancit klubi nuk ka hyrë në marrëveshje të transferimit.